



A K T - T H E M E L I M I

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "NEAL - 86" SH.P.K. "ORTAKI VETËM"

Në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare, Unë,
Skënder Këndezi, biri i Aliut, dl. 05.03.1957, lindur në Tiranë e banues në
lagjen 4 Sarandë, sot më datën 24.09.2001, në Sarandë, vendosa të themeloj
shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve që vijojnë:

N E N I 1

Të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "NEAL
86" Shpk. "Ortak i vetëm".

N E N I 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

- Veprimtari tregëtimi të mallrave të ndryshme në vend e import-eksport
- Veprimtari në fushën e ndertimeve industriale, civile, rrugë, ujësjellës, kanalizime, rikonstruksione etj. dhe prodhimit të material-ndertimit e tregëtimin e tyre në vend e import eksport

N E N I 3

Selia e shoqërisë "NEAL - 86" Shpk. "Ortak i vetëm" ndodhet në
Republikën e Shqipërisë, në lagjen nr. 4, pranë ish Parkut të mallrave, Sarandë.

N E N I 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është për mbi 10 vjet.

N E N I 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në 100 kuota me
nga 1000 lekë secila kuotë. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar disponohen nga
"Ortaku i vetëm".

N E N I 6

Kuotat e shoqërisë të depozituara nga "ortaku i vetëm" në kapitalin themeltar
janë të transferueshme me pëlqimin e tij, me akt noterial, ose në bazë të dispozitave
të tjera ligjore.



N E N I 7

“Ortaku i vetëm” mund të vendosë në çdo kohë për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kapitali themeltar është i depozituar në bankën shqiptare ose tek noteri dhe i nënshkrueshëm nga “ortaku i vetëm”.

N E N I 8

Shoqëria administrohet nga administratori Skënder Këndezi, i cili ka kompetenca të plota për drejtimin dhe administrimin e shoqërisë. Përfaqson shoqërinë në lidhje me të tretët dhe në organet e drejtësisë. Gjithashtu ka të drejtë të ndërmarrë veprime në instancat administrative e gjyqësore për mbrojtjen e interesave të shoqërisë.

N E N I 9

Punësimi i personave të tretë në shoqëri do të bëhet në bazë të kontratës individuale të punës dhe do të zbatohet legjislacioni shqiptar i punës për të gjitha problemet që nuk parashikohen në kontratën individuale të punës.

N E N I 10

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti.

Në mbylljet financiare, administratori ndjek hartimin e llogarisë vjetore në pajtim me dispozitat ligjore. “Ortaku i vetëm” miraton bilancet në se është e nevojshme, pas raportit të revizorëve të kontabilitetit brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

N E N I 11

“Ortaku i vetëm” gëzon të drejtën për tërheqjen e fondeve të nevojshme të kapitalit themeltar nga bankat shqiptare, ose noteri, duke depozituar firmën si firmë e parë pranë asaj banke.

N E N I 12

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të shoqërisë, e cila me krijimin e saj merr përsipër detyrimin.



N E N I 13

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve brenda e jashtë shoqërisë, me persona fizikë e juridikë zgjidhen nga Gjykata kompetente shqiptare, Gjykata e rrethit Sarandë.

N E N I 14

Për sa nuk është shprehur në këtë akt-themelimi, shoqëria i referohet çdo ligji të veçantë përkatës që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

N E N I 15

Ky akt-themelimi hartohet në katër kopje për t'u depozituar në organet kompetente, njëra prej të cilave mbetet pjesë e dokumentacionit të shoqërisë "NEAL - 86" Shpk. "Ortak i vetëm" me qendër në lagjen 4, pranë ish Parkut të Mallrave, Sarandë.

"ORTAKU I VETËM"

Skënder Këndezi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË SARANDË

Nr. 59 rep.

V È R T E T I M

Sot më datën 01.10.2001, para meje noterit Genci Nikolla, paraqit personalisht kërkuesi: Skënder Këndezi, biri i Aliut, dl.05.03.1957, lindur në Tiranë e barmes në lagjen 4 Sarandë, i cili deklaroi se ka redaktuar jashtë kësaj zyre akt-themelimin e shoqërisë dhe është nënshkruar prej tij. Unë noteri vërtetoj nënshkrimin në bazë të ligjit.

N O T E R I

Genci Nikolla

